



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

---

Numri i lëndës: 2021:026495  
Datë: 05.12.2023  
Numri i dokumentit: 05016346

**C.nr.268/21**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË** - Departamenti i Përgjithshëm, sipas gjyqtarit, Besnik Shala, në çështjen juridike civile të procedurës kontestimore të paditëses S.J nga K-Istog, të cilën e përfaqëson Av. F. B në Pejë rr. ”.....”, kundër të paditurës K.S.P zyra qendrore Prishtinë, me bazë juridike Zhdëmtim sipas auto-përgjegjësisë , vlera e kontestit 1,000 euro, jashtë seance me datë 05.12.2023, bie këtë:

**A K T V E N D I M**

**KONSTATOHET E TËRHEQUR** padia e paditësit paditëses S.J nga K-Istog, kundër të paditurës K.S.P zyra qendrore Prishtinë, me bazë juridike Zhdëmtim sipas auto-përgjegjësisë , vlera e kontestit 1,000 euro.

**A r s y e t i m**

Paditësja për mes të autorizuarit të tij pranë Gjykatës Themelore në Pejë, kanë ushtruar padi me dt.11.02.2021, kundër të paditurës, me bazë juridike Zhdëmtim sipas auto-përgjegjësisë, vlera e kontestit 1,000 euro.

I autorizuari i paditësit me parashtrësën e datës 14.11.2023, e ka njoftuar gjykatën se e tërheqë padinë ndaj të paditurës, për shkak se me të njëjtën kemi arritur ujdj jashtëgjyqësore, andaj gjykata me dt.16.11.2023 e ka njoftuar palën e paditurën për tërheqjen e padisë së paditësit, ku e njëjta njoftimin e ka pranuar me datë 22.11.2023, dhe nuk është përgjigjur, andaj pasi që e paditura nuk është përgjigjur fare në njoftimi e gjykatës konsiderohet se ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.

Sipas dispozitës së nenit 261.1, LPK-së, e cila parashikon se paditësi mund ta tërheq padinë, pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin, në të cilën i padituri paraqet në gjykatë përgjigje në padi, gjersa paragrafi 2, parashikon se padia mund të tërhiqet edhe më vonë gjerë në përfundim të shqyrtimit kryesor, në çoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri

brenda afatit prej 7 dite, nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e njëjta e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.

Andaj duke u mbështetur në dispozitën e nenit 261 par. 2, 3, dhe 4 e lidhur me nenin 387 par. 1 pika c) të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**C.nr.268/21 dt.05.12.2023**

**Gjyqtari**  
Besnik Shala

**KËSHILLA JURIDIKE**

Kundër këtij aktvendimi nuk është lejuar ankesa,  
Konform nenit 261 pra.4 të LPK-së.